



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2018:044580
Datë: 12.09.2024
Numri i dokumentit: 06153390

PAKR.nr.416/2024

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS - Departamenti për të Krime të Rënda, kolegji i përbërë nga gjyqtarët Beqir Kalludra, kryetar i kolegjit, Hashim Çollaku dhe Ferit Osmani, anëtar, me bashkëpunëtorin profesional Lavdrim Latifi, procesmbajtës, në çështjen penale kundër të akuzuarit B.P., nga fshati K..., Komuna e Pejës, për shkak të veprës penale vrasje e rëndë, nga neni 179 par.1 pika. 1.11 të KPK, duke vendosur sipas ankesës së Prokurorisë Themelore në Pejë, si dhe ankesës së mbrojtësit së të akuzuarit B.P., av.Besnik Berisha, të ushtruara kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Pejë – Departamenti për Krime të Rënda, PKR.nr.145/2021, të dt.27.05.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur me dt.26.08.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohen, si të pabazuara ankesat, e Prokurorisë Themelore në Pejë, si dhe mbrojtësit së të akuzuarit B.P., av.Besnik Berisha, kurse aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Pejë – Departamenti për Krime të Rënda, PKR.nr.145/2021, të dt.27.05.2024, **vërtetohet**.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Pejë – Departamenti për Krime të Rënda, PKR.nr.145/2021, të dt.27.05.2024, është shpallur fajtor i akuzuari B.P., për shkak të veprës penale vrasje e rëndë, nga neni 179 par.1 pika 1.11 të KPK, dhe i shqiptuar dënimi me burgim në kohëzgjatje prej 23 (njëzetetre) viteve, në të cilin dënim i është llogaritur koha e kaluar në paraburgim nga dt.22.07.2017, gjerë me dt.22.02.2018, në arrest shtëpiak, nga dt.22.02.2018, gjerë me dt.16.02.2021, si dhe në paraburgim nga dt.16.02.2021, gjerë në përfundim të dënimit të shqiptuar me burgim.

Është obliguar i akuzuari që të paguaj shpenzimet e procedurës penale në shumën prej 100Euro, paushallin gjyqësor në shumën prej 100Euro, si dhe në emër të Fondit për Kompensimin e Viktimave të Krimit, shumën prej 50 Euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditëve, pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Për realizimin e kërkesës pasurore juridike, pala e dëmtuar udhëzohet në kontestin e rregullt civilo juridik.

Të akuzuarit B.P., pas shpalljes së aktgjykimit i është vazhduar paraburgimi, i cili do të zgjasë gjerë në përfundim të dënimit të shqiptuar me burg.

Kundër këtij aktgjykimi, në afatin ligjor ankesë kanë ushtruar:

-Prokuroria Themelore në Pejë, për shkak të vendimit për dënimin, dhe ka kërkuar që të akuzuarit ti ashpërsohet vendimi për dënimin, dhe ti shqiptohet dënim më i ashpër, pasi që të ndryshohet aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Pejë – Departamenti për Krime të Rënda, PKR.nr.145/2021, i dt.27.05.2024, dhe

-mbrojtësi i të akuzuarit B.P., av.Besnik Berisha, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, shkeljeve të ligjit penal, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, si dhe vendimit lidhur me sanksionin penal dhe ka propozuar që aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë, të ndryshohet dhe i akuzuari të lirohet nga akuza, apo që të anulohet dhe çështja penale ti kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim e vendosje.

Prokuroria e Apelit në Prishtinë, me shkresën PPA/I.nr.379/2024, të datës 15.07.2024, duke u sqaruar përkitazi me ankesën e ushtruar nga ana e Prokurorisë Themelore në Pejë – Departamenti për Krime të Rënda, ka propozuar që e njëjta të aprovohet si e bazuar, kurse aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Pejë – Departamenti për Krime të Rënda, PKR.nr.145/2021, të dt.27.05.2024, të ndryshohet dhe të akuzuarit ti shqiptohet dënim më i ashpër me burgim, kurse sa i përket ankesës së mbrojtësit së të akuzuarit B.P., av.Besnik Berisha, e njëjta të refuzohet si e pabazuar.

Në kuptim të nenit 390 të KPPK, kolegji i kësaj gjykate ka caktuar seancën e kolegjit për dt.26.08.2024, dhe në mënyrë të rregullt i ka njoftuar të gjitha palët nga shkresat e lëndës.

Në seancë të kolegjit kanë prezantuar, i akuzuari B.P., mbrojtësi i të akuzuarit, av.Besnik Berisha, ndërsa nuk kanë prezantuar Prokurori i Apelit, e dëmtuara Sh.B., përfaqësuesi i zyrës për mbrojtjen e viktimave dhe ndihmën e viktimave, edhe pse kanë qenë të njoftuar në mënyrë të rregullt, e cila vërtetohet nga shkresat e lëndës.

Mbrojtësi i të akuzuarit B.P., av.Besnik Berisha, ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë ankesës së ushtruar, duke theksuar se në këtë çështje penale gjykata e shkallës së parë, përkundër asaj që është dashur që në rigjykim ti eliminoj mangësitë të cilat janë konstatuar nga ana e Gjykatës së Apelit, të njëjtat nuk i ka eliminuar, dhe se në këtë çështje penale nuk e ka vërtetuar motivin e kryerjes së veprës penale.

I akuzuari B.P., deklaron se e mbështet në tërësi ankesën e ushtruar nga ana e mbrojtësit së tij, av.Besnik Berisha, si dhe paraqitjen e tij në seancë të kolegjit.

Gjykata e Apelit në kuptim të nenin 394 të KPPK, duke vlerësuar pretendimet ankimore nga ankesat e ushtruara, nga ana e Prokurorisë Themelore në Pejë, mbrojtësit së të akuzuarit B.P., av.Besnik Berisha, aktgjykimit të ankimuar, propozimit me shkrim të Prokurorisë së Apelit në Prishtinë, si dhe shkresave tjera të lëndës ka gjetur se:

Ankesat, e Prokurorisë Themelore në Pejë, si dhe mbrojtësit së të akuzuarit B.P., av.Besnik Berisha, nuk janë të bazuara

Sipas ankesës së mbrojtësit së të akuzuarit B.P., av.Besnik Berisha, aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë është ankimuar për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, të cilat konsistojnë në kuptim të nenit 384 par.2 nën par.2.1, 2.2 dhe 2.7 dhe lidhur me nenin 369 par. 7 të KPPK, si dhe lidhur me nenin 3.2, 7.2, 8.2,9.1, 119.2, 360,364 dhe 406 të KPPK, të cilat kanë ndikuar drejtpërdrejtë në marrjen e vendimit gjyqësor jo të drejtë dhe të ligjshëm. Gjykata e shkallës së parë nuk ka dhënë arsye të mjaftueshme sa i përket dispozitivit të aktgjykimit, që nënkupton se i njëjti është i mangët i pa qartë dhe i pa kuptueshëm, në kundërshtim të plotë me brendinë e tij dhe arsyetimin si dhe me shkresat e tjera të lëndës, që përfshihen me shkeljet nga neni 364 par.1 dhe 369 par.7 të KPPK. Po ashtu nuk janë dhënë arsye të mjaftueshme lidhur me faktet vendimtare, me të cilat do të vërtetohet ekzistimin e veprës penale, por gjendja faktike në këtë çështje penale është vërtetuar në bazë të provave rrethore të cilat janë konfuzë, të pa qarta, të pasakta, juridikisht të pa qëndrueshme, si dhe në kundërshtime shkresat e lëndës. Po ashtu nuk është vërtetuar dhe vlerësuar çdo provë për ti dhënë lidhje me provat e tjera, andaj edhe në këtë drejtim është zbatuar gabimisht dispozita ligjore, nga neni 360 par.2 të KPPK. Nga ana e gjykatës së shkallës së parë, nuk është ekzaminuar dëshmitarja Sh.B., andaj e gjitha paqartësitë lidhur me këtë çështje penale, të cilat kanë pa mundur që të vërtetohet ekzistimi i veprës penale, kanë qenë jo të qarta, andaj edhe kemi të bëjmë me shkeljen e parimit “indubio pro reo”. Gjykata e shkallës së parë ka lëshuar rastin që të zbatohet dispozitën ligjore nga neni 406 të KPPK, për të vepruar sipas të gjitha mangësive të cilat janë konstatuar nga ana e Gjykatës së Apelit, e cila me aktvendimin PAKR.nr.132/2021, të dt.23.05.2021, në mënyrë të qartë ia ka listuar për të vepruar sipas tyre. Në këtë çështje penale të gjitha kontradiktat të cilat ekzistojnë nga shkresat e lëndës, gjykata e shkallës së parë është mundur që ti bazoj në deklaratën e dëshmitarit J.G., mirëpo deklaratata e tij në këtë çështje penale nuk ka paraqitur kredibilitet për të vërtetuar ekzistimin e veprës penale.

Në mënyrë të pa dyshimtë janë vërtetuar elementet e veprës penale, sipas gjykatës së shkallës së parë, mirëpo paraqitet pyetja, se nga ana e po të njëjtës gjykatë a janë vërtetuar të gjitha elementet të cilat e karakterizojnë veprën penale të vrasjes së rëndë, nga neni 179 par.1 pika 1.11 të KPK, në fuqi në kohën e kryerjes së veprës penale, të cilat elemente të veprës penale gjykata e shkallës së parë nuk ka mundur që të vërtetohet për të ardhur në përfundim se nga ana e të akuzuarit B.P., është kryer kjo vepër penale, dhe si rezultat i kryerjes së të njëjtës, i kanë humbur jetën tani të ndjerët vëllezërit R.A.B. dhe A.A.B.. Mos vërtetimi i elementeve inkriminuese të veprës penale, nga provat, nga shkresat e lëndës, të proceduara dhe atë sikurse janë provat personale, deklaratata e të akuzuarit, i cili është mbrojtur në heshtje, deklaratata e të dëmtuarës Sh.B., vlerësimi i deklaratave të dëshmitarëve Xh.P., V.P., I.P., N.P., Z.K., B.P., L.P., ekspertit të telekomunikacionit M.H., që

të gjitha këto prova, nuk kanë mundur që të provojnë se i akuzuari ka kryer veprën penale për të cilën është akuzuar, dhe si rezultat i vërtetimit të të njëjtëve, jemi të mendimit se nuk ekzaltojnë elementet inkriminuese të veprës penale se i akuzuari B.P., ka kryer veprën penale të vrasjes së rëndë.

Kolegji i Gjykatës së Apelit, ka vlerësuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, sipas ankesës së mbrojtësit së të akuzuarit B.P., av. Besnik Berisha, dhe ka ardhur në përfundim se i njëjti nuk përfshihet me shkeljet e pretenduara nga ankesa e ushtruar, të parapara në nenin 384 të KPPK, për të cilat shkelje përkujdeset edhe sipas detyrës zyrtare, në kuptim të nenit 394 të KPPK.

Kolegji ka ardhur në përfundim se dispozitivi i aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë, është i qartë, i kuptueshëm dhe në harmoni me vetveten, si dhe pjesë të tjera të aktgjykimit, ngase përmban arsyet, lidhur me faktet vendimtare të cilat e karakterizojnë veprën penale e cila i vihet në barrë të akuzuarit.

Gjithashtu kolegji e vlerëson aktgjykimin dhe vije në përfundim se i njëjti nuk përfshihet me shkeljet e pretenduara nga neni 3.2 i KPPK, sepse të gjitha veprimet inkriminuese të veprës penale janë provuar në mënyrë të bollshme, për të vërtetuar që në veprimet e të akuzuarit, kemi të bëjmë me veprën penale të vrasjes së rëndë nga neni 179 par.1 pika 1.11 të KPK.

Po ashtu duke bërë vlerësimin e ankesës së mbrojtësit së të akuzuarit, kolegji vlerëson se ngase i njëjti nuk përfshihet as me shkelje nga neni 7 të KPPK, sepse të gjitha palët i kanë vu në dispozicion të gjitha detyrimet të cilat i përkasin, neni 8.2 të KPPK, duke e respektuar parimin e pavarësisë së gjykatave, pastaj neni 9.1 të KPPK, ngase barazia e palëve është respektuar në masë të duhur, neni 360 dhe 364 i KPPK, duke u përkujdesur për bazën e aktgjykimit, nëse i njëjti është bazuar vetëm në fakte dhe prova të proceduara në shqyrtimin gjyqësor, me rastin e nxjerrjes së aktgjykimit dënues, ashtu që në këtë çështje penale gjykata e shkallës së parë ka respektuar formën dhe përmbajtjen e aktgjykimit me shkrim të paraparë në nenin 369 të KPPK.

Kolegji vlerëson se në këtë çështje penale gjykata e shkallës së parë, ka dhënë arsye të mjaftueshme, përkritazi në çdo pikë të aktgjykimit duke dhënë arsye të bollshme për paraqitjen e veprës penale e cila i vihet në barrë të akuzuarit. Nga ana e gjykatës së shkallës së parë, në mënyrë të qartë dhe të thuktë janë paraqitur në mënyrë të plotë se cilat fakte konsiderohen të vërtetuara apo të pa vërtetuara, duke dhënë arsye për secilin veprim inkriminues të akuzuarit në kryerjen e veprës penale, e po ashtu edhe në mënyrë të veçantë ka vlerësuar saktësinë e secilës provë në këtë çështje penale, si dhe ka vlerësuar edhe kundërthëniet përkritazi me çështjet e ngritura, e po ashtu ka dhënë arsye të duhura për çdo propozim i cili ka qenë relevant për zgjedhjen e çështjes juridike, veçanërisht për vërtetimin e ekzistimit të veprës penale të vrasjes së rëndë nga neni 179 par.1 pika 1.11 të KPK.

Nga kjo rezulton se sa i përket pikave të ezauruara më lartë, kolegji ka vlerësuar se në këtë çështje penale gjykate e shkallës së parë, ka vepruar në kuadër të dispozitave përkatëse ligjore, e sidomos ka pasur parasysh dispozitën ligjore nga neni 406 i KPPK, sepse ka bërë vlerësimin e të gjitha provave, të cilat janë proceduar, si dhe të gjitha veprimeve të rekomanduara nga ana e

gjykatës së shkallës së parë, për të nxjerr aktgjykim sa më të drejtë, përkitazi me shpalljen fajtor të akuzuarit B.P..

Po ashtu kolegji ka vlerësuar se të gjitha veprimet e ndërmarra kanë qua në drejtim të asaj që gjykata e shkallës së parë të nxjerrë aktgjykim dënuese, dhe pasi që ka vlerësuar dhe vërtetuar ekzistimin e veprës penale, atëherë kolegji është i bindur se në këtë çështje penale aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë nuk përfshihet me shkelje të dispozitave të procedurës penale.

Edhe sa i përket vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, nga ana e gjykatës së shkallës së parë është ushtruar ankesa nga ana e mbrojtësit së të akuzuarit B.P., av.Besnik Berisha, i cili e ankimon aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, duke pretenduar se në këtë çështje penale gjykata e shkallës së parë, nuk ka arritur që të vërtetoj motivin e kryerjes së të njëjtës, e po ashtu nuk ka arritur që të vërtetoj se natën kritike, vepra penale është kryer nga ana e të akuzuarit B.P., çfarë ka qenë mënyra e kryerjes së veprës penale, se a janë tërhequr apo jo kufomat e të dëmtuarve, pas kryerjes së veprës penale, ngase edhe nga deklaratat e dëshmitarit J.G., rezulton se i njëjti nuk ka vërejtur askënd që ka kryer këtë vepër penale dhe parashtrohet pyetja, si është e mundur që pa ndonjë dëshmitar të përmbillet kjo çështje penale, me çrast sikurse theksohet që nga ana e të akuzuarit B., nga arma automatike e llojit të pa njohur, fillimisht janë shkrepur tre fishek dhe A., niset në drejtim të R., e pastaj i akuzuari përsëri në rafal gjuan në drejtim të tyre, gjithsejtë njëmbëdhjetë herë, duke i privuar nga jeta tani të ndjerët A. e R. Berisha, e më pastaj trupat e të ndjerëve i largon nga pylli, duke i tërhequr 61m, nga vendi i ngjarjes dhe i vendos në pjesën të cilën nuk ka pronar. Nga brendësia e këtij dispozitivi gjykata e shkallës së parë, në mungesë të fakteve të vërtetuara bënë kalimin arbitrar dhe të pa shpjegueshëm, duke përshkuar zhvillimin e ngjarjes me autor të pa njohur, ashtu që pasi që nuk mund të provohet se i akuzuari ka kryer veprën penale për të cilën është akuzuar, është dashur që të nxjerr aktgjykim lirues në këtë çështje penale, sepse edhe vetë dispozita ligjore nga neni 369 par.6 të KPPK, na obligon që gjykata në arsyetim të aktgjykimit, duhet të paraqet arsyen për çdo pikë të aktgjykimit, kurse në rastin konkret mungon.

Dëshmisë së dëshmitarit I.G., të dhënë në rishqyrtim gjyqësor me dt.22.04.2022, dhe 18.07.2022, gjykata nuk i fal besimin, ngase në rigjykim, i njëjti ka deklaruar se i mohon deklaratat e dhëna, sikurse është ajo në polici dhe në prokurori, kurse të vërtetën e ka deklaruar në deklaratën e dhënë me dt.14.12.2018.

Parashtrohet pyetja që dëshmitarit J.G., a duhet ti besohet dhe një deklaratë të tillë, sepse e njëjta nuk përputhet me deklaratat e dhëna më parë, dhe duke pasur parasysh dispozitën ligjore nga neni 369 par.7 të KPPK, me një deklaratë të këtillë a mund të vërtetohen elementet inkriminuese të veprës penale, ngase deklaratat e dhëna në polici dhe prokurori janë të kundërta me këtë lloj deklarate. Sa i përket deklaratës së B. P., përkatësisht mos dhënies deklarate të të njëjtit, ngase i njëjti është mbrojtur në heshtje, nuk mund të vihet në përfundim se i njëjti çfarë veprime ka ndërmarrë dhe po qesë analizohen edhe provat materiale, sikurse janë analizat dhe hartografia e numrit të tel.045-394-813, në pronësi të B. P., analiza dhe hartografia e nr.tel I.P. analiza e dy SMS, të nxjerrë nga telefoni i B.Pongjës, rezulton se të gjitha këto veprime të ndërmarra nga ana organeve nuk korrespondojnë me çështjen penale, dhe se nuk është dhënë

ndonjë arsye për besueshmërinë në këto prova. Pasi që gjykata ka dështuar të vërtetoj ekzistimin e veprës penale, dhe se sikurse provat materiale po ashtu personale nuk janë bindëse për të vërtetuar ekzistimin e veprës penale, atëherë e vetmja provë të cilën gjykata e shkallës së parë e ka shpallë të besueshme ka rezultuar në aktivizimin e antenave për të vërtetuar vendndodhjen e të akuzuarit, mirëpo nuk ka pasur parasysh që praktika e konsoliduar gjyqësore nuk e njeh si provë këtë veprim të ndërmarrë, andaj gjykata e shkallës së parë nuk ka mundur që të provoj se në veprimet e të akuzuarit janë formuluar elementet qenësore të veprës penale e cila i vihet në barrë.

Edhe nga dëshmitë e dëshmitarëve M.P., nuk rezulton se B.P., ka kryer veprën penale e cila i vihet në barrë, që ditën kritike ti ketë privuar nga jeta këtu të dëmtuarit, e cila nuk mund të vërtetohet edhe nga deklaratat e të dëmtuarës Sh.B., e cila nuk ka qenë në vendin e ngjarjes kur është kryer vepra penale, deklaratës së Sh.B., andaj të gjitha këto dëshmi nuk japin rezultatin që i akuzuari e ka kryer veprën penale dhe natën kritike i ka privuar nga jeta këtu të dëmtuarit.

Kolegji i kësaj gjykate ka vlerësuar ankesën e mbrojtësit së të akuzuarit, ankesën e gjykatës së shkallës së parë, si dhe shkresat e lëndës, de ka ardhur në përfundim se në këtë çështje penale gjendja faktike është vërtetuar se në veprimet e të akuzuarit janë formuluar elementet qenësore të veprës penale të vrasjes së rëndë, nga neni 179 par.1 pika 1.11 të KPK, sepse me dt.21.07.2017, rreth orës 21:30minuta në fshatin Kosuriq, të Pejës, në pyllin e fshati Kosuriq, në vendin e quajtur Tavnik, i cili është pronë e familjes së të akuzuarit, për shkak të mosmarrëveshjeve të atëçastshme për shkak të prerjes së pyllit i akuzuari B.P. me dashje i ka privuar nga jeta tani të ndjerët vëllezërit R.A.B. dhe A.A.B., pasi që tani të ndjerët së bashku me shokun e tyre dëshmitarin J.G., rreth orës 21:00, janë nisur me dy qerre me kuaj, për në pyll, dhe pasi që arrijnë në afërsi të pyllit, duke ditur se pylli është i huaji, i kanë lënë qerret me kuaj buzë rrugës dhe kanë hyrë në pyll, ashtu që kanë filluar të prenë dru, mirëpo kanë dëgjuar një zë që i është drejtuar R. me fjalë “ndal, ndal”, dhe pastaj J., vrapon në drejtim të A., duke i thënë se dikush është në mal, dhe e merr përgjigjen Po, nga ana e A., pastaj dëgjojnë kur R. iu drejtohet me fjalët “djema mos hajdeni se gjithçka është në rregull”, atëherë A. ka bërë titur duke thënë edhe pse nuk ka vërtetuar askënd, “kush hamamin jeni ju”, në atë moment i akuzuari nga arma automatike e llojit të panjohur ka shkrepur tre fishek dhe A. niset në drejtim të R., kurse në atë moment i akuzuari përsëri gjuan në drejtim të tyre, gjithsejtë njëmbëdhjetë herë dhe i privon nga jeta të ndjerët A. e R. B., pastaj trupat e tyre i largon nga pylli, duke i tërhequr për afërsisht 61m, nga vendi i ngjarjes dhe i vendos në pjesën e cila nuk ka pronar. Nga ky përshkrim faktik i kryerjes së veprës penale nga ana e të akuzuarit, kolegji i kësaj gjykate vlerëson se gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë dhe të qartë ka vlerësuar se në veprimet e të akuzuarit janë formuluar të gjitha elementet qenësore të veprës penale të vrasjes së rëndë, ngase natën kritike i akuzuari B.P., me armën automatike, të tipit të pa njohur me shkrepjen e njëmbëdhjetë fishekëve i ka privuar nga jeta tani të dëmtuarit, e pasi që i ka privuar nga jeta të ndjerin i ka tërhequr zvarrë përkatësisht 61m, duke i vendosur në pjesën e pyllit që nuk është pronë e tyre, me qëllim që ti largon nga prona e vet, ashtu që me një veprim të tillë, në mënyrë të pa dyshimtë vërtetohen elementet e veprës penale e cila vihet në barrë të akuzuarit. Po ashtu edhe me dëshmitë e të gjitha provave, sikurse janë ato materiale, analizimin e masave të fshehta, monitorimin e fshehtë të bisedave të përfshira në kallëzimin penal, raporti hetues të dt.24.07.2017, lidhur me analizimin e bisedave telefonike (listingu dhe ekzaminimi i telefonit të pandehurit B.P.), foto albumi mbi ekzistimin e automjetit, foto albumin mbi ekzaminim

e rrobave të dosjes së forenzikës, fotoalbumin e vendit të ngjarjes, lista e dëshmimeve të njëjtit të forenzikës, kallëzimin penal, plotësimin e kallëzimit penal, raporti i ekspertimit të mbetjeve nga baroti ose kapsulave inicuese pas qitjeve me armë zjarri, raporti i ekspertimit lidhur me ekzaminimin daktiloskopik të dëshmimeve, raportet e ekzaminimit balistik të ADN, raporti i autopsisë për tani të ndjerët R. e A.B., si dhe vlerësimi i të gjitha dëshmimeve nga shkresat e lëndës, sikurse është deklarata e të dëmtuarës Sh.B., deklarata e dëshmitarit Sh.B., deklarata e dëshmitarit J.G., deklarata e dëshmitarit Z.K., deklarata e dëshmitares L.P., I.P., I.P. N.P., procesverbali i rekonstruimit të vendit të ngjarjes, si dhe raporti i të njëjtit, certifikata mbi pa luajtshmërin – fleta poseduese me nr.P-71611043-00005-106, i dt.06.05.2019, si dhe identifikimi katastral me listë përkatëse poseduese, si dhe të gjitha veprimet e tjera të ndërmarra, gjykata e shkallës së parë i ka vlerësuar që të gjitha këto prova dhe u ka dhënë lidhje të pa shkëputura, ashtu që ka vërtetuar se në veprimet e të akuzuarit janë formuluar elementet qenësore të verës penale e cila i vihet në barrë të akuzuarit.

Kolegji ka vlerësuar një nga një se cilat prova personale, duke filluar nga deklarata e të dëmtuarës – dëshmitares Sh.B., nga e cila vërtetuar se natën kritike këtu i akuzuari i ka privuar nga jeta të dëmtuarit, dhe se e njëjta nuk ka qenë prezentë në vend të ngjarjes, por kur ka shkuar ka vërejtur një pellë të gjakut të të ndjerëve R. e A. Berisha, i derdhur në malin e familjes P., dhe se kufomat e tani të ndjerëve ishin tërhequr zvarrë për tu dërguar në malin me pronar tjetër, gjegjësisht të familjes Ukaj. Po ashtu edhe nga vlerësimi i deklaratës së dëshmitarit J.G., ka rezultuar se natën kritike këtu të dëmtuarit janë vlarë, dhe ngjarja ka ndodhur rreth orës 21:00-21:30 mintua, duke përshkruar mënyrën e shkuarjes deri në pyll, fillimin për të prerë dru, dhe më pastaj vrasjen e të njëjtëve, nga ana e këtu të akuzuarit, ashtu që kjo deklaratë e të njëjtit e dhënë në shqyrtim gjyqësor, përputhet me veprimet e ndërmarra nga ana e të njëjtëve. Dëshmitarët Sh.B, M.P., V.K., H. R., E.P., J.K., përkundër asaj që janë deklaruar lidhur me këtë rast, të njëjtit nuk kanë qenë në vendin e ngjarjes, mirëpo gjykata i ka vlerësuar deri në atë masë që kanë mundur të kontribuojnë në vërtetimin e ekzistimit të veprës penale.

Nga ekspertiza e mjekësisë ligjore, Dr.A. Gërxhaliu, është bërë përshkrimi i kufomave të të ndjerëve A. e R. B., duke konstatuar relativisht një numër të madh të hyrjeve dhe daljeve të predhave të shkrepur nga arma e zjarrit, të cilat në të dyja rastet kanë atakuar organet vitale të cilat edhe kanë sjellë deri te vdekja, pasi që të njëjtat kanë qenë të rrufeshme. Sa i përket tani të ndjerit R., sidomos ana e djathë e shpinës, por edhe e majtë ka gërvishtje me minus epidermë, sikurse edhe tani të ndjerit A., ashtu që këto janë shenja që kufomat janë tërhequr. Në përshkrimin e lëndimeve trupore, në trupin e të ndjerit A. B., ka bërë përshkrimin se lëndimet janë në pjesën e abdomenit të fusha abrezive, kurse sa i përket tani të ndjerit R. B., edhe te ky ka bërë përshkrimin duke theksuar se pjesa e pasme fundore e shpinës ka pasur gërvishje vijëzohet ashtu që i njëjti ka bërë përshkrimin e plagëve të marra sa i përket tani të ndjerit A., duke deklaruar se kemi dy plagë tangjentare-skajore të cilat përfshihen vetëm në pjesët skajore.

Pasi që i njëjti ka bërë përshkrimin e lëndimeve të marra nga ana e këtu të akuzuarit gjykata e shkallës së parë, ka vlerësuar si tërësi këtë çështje penale, duke iu dhënë lidhje të pa shkëputura sikurse provave personale, po ashtu edhe materiale, dhe në mënyrë të drejtë ka

vendosur kur të akuzuarin e ka shpallur fajtor për veprën penale vrasje e rëndë nga neni 179 par.1 pika 1.11 të KPK dhe i ka shqiptuar dënimin përkatës ligjor.

Pretendimet ankimore nga ankesa e mbrojtësit së të akuzuarit, kolegji i kësaj gjykate i ka vlerësuar dhe ka ardhur në përfundim se të njëjtat nuk janë të bazuara, ngase nga provat të cilat janë të renditura në aktgjykim të gjykatës së shkallës së parë, pasi që është vërtetuar se në veprimet e të akuzuarit, eksitojnë tiparet e veprës penale për të cilat i akuzuari është shpallur fajtor, atëherë të njëjtat vërtetojnë se i akuzuari ka kryer këtë vepër penale, kurse sa i përket parimit “indubio pro reo”, në këtë çështje penale, nuk ka vend për aplikim, sepse provat të cilat gjykata e shkallës së parë u ka falë besimin, kanë fuqinë juridike të duhur që qojnë në drejtim të asaj që i akuzuari të shpallet fajtor dhe të dënohet sipas ligjit.

Edhe sipas shkeljeve të ligjit penal, mbrojtësi i të akuzuarit e ka ankimuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, duke pretenduar se në këtë çështje penale, gjykata e shkallës së parë, nuk ka vërtetuar se në veprimet e të akuzuarit, janë formuluar elementet qenësore të veprës penale, të vrasjes së rëndë, nga neni 179 par.1 pika 1.11 të KPK, sepse është dashur që të vlerëson të gjitha provat personale dhe materiale, të cilat nuk janë vlerësuar në masë të duhur dhe si rezultat i të njëjtëve në këtë çështje penale, është bërë edhe shkelja e ligjit penal në kuptim të nenit 385 par.1 të KPPK, sepse nuk ka elemente të bollshme për të vërtetuar ekzistimin e të njëjtit, ngase me asnjë veprim të akuzuarit B.P., nuk vërtetohet ekzistimi i kësaj vepre penale.

Shkeljet esenciale si dhe vërtetimi i gabuar dhe jo i plotë i gjendjes faktike, qojnë në drejtim të asaj që është bërë edhe shkelja e ligjit penal, andaj gjykata e shkallës së parë në këtë çështje penale është dashur që të nxjerr aktgjykim lirues.

Kolegji i kësaj gjykate ka vlerësuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, sipas ankesës së mbrojtësit së të akuzuarit B.P., av.Besnik Berisha, dhe ka ardhur në përfundim se në këtë çështje penale, aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë nuk përfshihet në shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale, si dhe vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, sepse me të gjitha provat të cilat i ka proceduar, ka vërtetuar se në veprimet e të akuzuarit, janë formuluar elementet qenësore të veprës penale të vrasjes së rëndë, nga neni 179 par.1 pika 1.11 të KPK, që nënkupton se ekzistimi i veprës penale nuk është kontestues, dhe se vepra penale për të cilën është akuzuari i akuzuari, është e paraparë në ligjin e aplikueshëm në kohën e kryerjes së veprës penale, se nuk ka gjetur rrethana të cilat e përjashtojnë të akuzuarin nga ndjekja penale si dhe përgjegjësia penale, dhe se pasi që është vlerësuar se i njëjti ka kryer veprën penale për të cilën është shpallur fajtor, gjykata e shkallës së parë, ka marrë vendim përkatës ligjor, sikurse në dispozitiv të aktgjykimit.

Po ashtu kolegji vlerëson se në këtë çështje penale gjykata e shkallës së parë ka vepruar në kuadër të kompetencës ligjore dhe se të gjitha vendimet nga të cilat janë marrë, sa i përket vendimit për dënimin, paraburgimit pas përfundimit të shqyrtimit gjyqësor, si dhe vendimeve të tjera në këtë çështje penale, që të gjitha janë marrë në kuptim të dispozitave përkatëse ligjore.

Nga ankesa e prokurorisë, aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë është ankimuar për shkak të vendimit për dënimin, duke theksuar se nga kjo çështje penale i akuzuari B.P., është shpallur fajtor për shkak të veprës penale të vrasjes së rëndë, nga neni 179 par.1 pika 1.11 të KPK dhe se gjykata e shkallës së parë, ka vlerësuar të mënyrë të drejt dhe të plotë se nga kjo çështje penale janë kryer dy vrasje, andaj është dashur që të ketë parasysh këtë rrethanë e sidomos mënyrën e kryerjes së veprës penale, ngase pasi që është shti në drejtim të të ndjerëve njëmbëdhjetë herë, dhe janë privuar nga jeta tani të ndjerët A. e R. Berisha, trupat e tyre janë tërhequr zvarrë nga pylli i tij, dhe në largësi prej 61m, nga vendi i ngjarjes janë vendosur në një pjesë tjetër, e cila nuk është pronë e të akuzuarit. Sa i përket kësaj çështje penale, kemi ardhur në përfundim se vendimi për dënimin nuk është në proporcion me peshën e veprës penale të kryer, pasi që rrethanat lehtësuese nga kjo çështje penale nuk janë gjetur, kurse si rrethana rënduese gjykata e shkallës së parë ka pasur mënyrën e kryerjes së veprës penale, ku janë vra dy persona, se janë tërhequr zvarrë pasi janë vrarë, andaj edhe dënimi i shqiptuar të akuzuarit nuk është në proporcion me veprën penale e cila i vihet në barrë të njëjtit.

Po ashtu gjykata e shkallës së parë është dashur të ketë parasysh edhe rrethanat personale të kryesit dhe sjelljen e tij, pas kryerjes së veprës penale e sidomos momentin e tërheqjes zvarrë, përafërsisht 61m, nga vendi i ngjarjes, për ti vendosur në pronën e cila nuk është e tyre. Duke i vlerësuar të gjitha këto rrethana jemi të mendimit që kjo ankesë duhet të aprovohet dhe të ndryshohet aktgjykimi Gjykatës Themelore në Pejë – Departamenti për Krime të Rënda PKR.145/21, të dt.27.05.2024, ashtu që të akuzuarit ti shqiptohet dënim më i ashpër.

Ankesë për shkak të vendimit lidhur me sanksionin penal, ka ushtruar edhe mbrojtësi i të akuzuarit av.Besnik Berisha, duke theksuar se në këtë çështje penale aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë manifestohet me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, si dhe shkeljes së ligjit penal, mirëpo gjykata e shkallës së parë duhet të ketë parasysh që në këtë çështje penale pasi që nuk është gjetur autori i kryerjes së veprës penale, atëherë edhe vendimi për dënimin nuk ka mbështetje të duhur ligjore. Në rastin hipotetik që po qesë i akuzuari B.P., vërtetë do të kishte qenë autor i vrasjes së dyfishtë, gjykata e shkallës së parë nuk i ka vlerësuar dispozitat ligjore, nga neni 69 dhe 70 të KPK, me rastin e marrjes së vendimit për dënimin, e sidomos nuk i ka vlerësuar rrethanat lehtësuese se i akuzuari është i moshës së re, se ka munguar motivi i kryerjes së veprës penale se është mbajtës i vetëm i familjes, se ka pasur sjellje korrekte ndaj organeve të ndjekjes dhe në gjykim, se është hera e parë që ka ra në kundërshtim me ligin, se ndaj tij nuk udhëhiqet ndonjë procedurë tjetër penale, andaj me dënim më të butë, mund të pritet që të arrëset efekti dhe qëllim i dënimit, dhe ka propozuar që të ndryshohet aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë, i akuzuari B.P., të lirohet nga akuza, ose që të anulohet aktgjykimi i ankimuar dhe çështja penale të kthehet në rigjykim dhe vendosje.

Kolegji i kësaj gjykate ka vlerësuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, për shkak të vendimit lidhur me sanksionin penal, sipas ankesave të ushtruara, nga ane a prokurorisë, si dhe mbrojtësit së të akuzuarit B.P., av.Besnik Berisha, së bashku me shkresat e tjera të lëndës, dhe ka ardhur në përfundim se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë nuk përfshihet me shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale, si dhe shkeljet e ligjit penal, se gjendja faktike është vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë, andaj gjykata e shkallës së parë, me rastin e marrjes së

vendimit për dënimin, caktimit të llojit dhe lartësisë së tij, ka vlerësuar të gjitha rrethanat e parapara në nenin 73,74 dhe 75 të KPK, rregullat e përgjithshme për matjen e dënimit, rregullat e përgjithshme për zbutjes ose ashpërsimin e dënimeve, si dhe zbutjen e dënimeve, duke konsideruar se në këtë çështje penale rrethana lehtësuese, nuk ka pasur, kurse si rrethana rënduese ka vlerësuar mënyrën e kryerjes së veprës penale, pasi që janë privuar nga jeta dy persona, mënyrën e kryerjes së veprës penale, e sidomos faktin që pas kryerjes së veprës penale, kufomat janë bartur nga vendi i ngjarjes duke u zhvendosur në vend tjetër, andaj me vlerësimin e këtyre rrethanave, gjykata e shkallës së parë ka qenë e bindur se me dënimin e shqiptuar sikurse në dispozitiv të aktgjykimit, do të arrihet efekti dhe qëllimi i dënimit.

Nga ankesa e prokurorisë, nuk ka gjetur ndonjë rrethanë posaçërisht rënduese, sikurse nuk ka gjetur as nga ankesa e mbrojtësit të akuzuarit B.P., av.Besnik Berisha, ndonjë rrethanë lehtësuese, kolegji është i bindur se për veprën penale të vrasjes së rëndë, nga neni 179 par.1 nën par.1.11 të KPK, dënimi i shqiptuar është në proporcion me përgjegjësinë penale juridike të akuzuarit, dhe se me dënimin e shqiptuar do të arrihet efekti dhe qëllimi i tij, që të parandalojë kryerësit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tyre, të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale, të bëjë kompensimin e viktimave ose të komunitetit për humbjet ose dëmet e shkaktuara nga vepra penale dhe të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit, të paraparë në nenin 38 të KPK-së.

Vendimi mbi kërkesën pasurore juridike, si dhe vendimet e tjera janë bazuar në dispozitat përkatëse ligjore sikurse është neni 462 par.3 i KPPK.

Vendimi mbi paraburgimin është marrë në kuptim të nenit 401 lidhur me nenin 366 par.1 pika 1.1 i KPPK.

Nga sa u tha më lartë e në kuptim të nenit 401 të KPPK, u vendos sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS
PAKR.nr.416/2024, të datës 26.08.2024

Bashkëpunëtori profesional,
Lavdrim Latifi

Anëtarët e kolegjit,
Hashim Çollaku

Kryetari i kolegjit,
Beqir Kalludra

Ferit Osmani